



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Data ____ / ____ / 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje automjet për MZSH”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi PCV 34144210-3 “Automjete zjarrëfikëse”

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fond limit : 5 795 000 *(pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë)* lekë pa tvsh, të vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.1 Ofertuesi duhet të paraqesi Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit.

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes (të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë në emër të vet për objektin e prokurimit, që vërteton cilësinë e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vetë natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që ofertuesit duhet të jenë të çertifikuar për cilësinë si dhe të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe çertifikata ekuivalente të ISO 9001:2015, e cila i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me sukses dhe në kohë.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetin) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.

- Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të këtyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë

në perputhje me karakteristikat apo specififikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, për mallrat objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specififikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

- 2.3.5 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie në të cilën të jenë të përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të mjetit nga autoriteti kontraktor dhe do të jetë:

Mjeti Zjarrëfikës Pick-Up 4x4, 1 (një) vit ose 100,000 km
(Kush të plotësohet e para nga këto të dy)

- 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): VII.3.B Nën Kategoria: – Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 9573, datë 03.07.2006, “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, i ndryshuar, VKM Nr. 107, datë 10.02.2016, “Për një shtesë në VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar” Udhëzim Nr. 1545, datë 29.03.2016 “Licencë për blerjen, shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkio”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

“...Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore...”

Disponimi i licencës së mësipërme nga ana e ofertuesve, garanton autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë staf Teknik:

- Ing. Mekanik për të paktën 6 muaj para datës së hapjes së ofertave dhe të jetë në listë pagesa, ku për këtë duhet të dorëzohen:
 - Kontrate pune e vlershme,
 - Diplome,

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 40, pika 5 te VKM-së Nr.285 datë 05.03.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 1 germa b, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të vërtetuar që subjekti që realizon kontratën disponon stafin e duhur teknik për realizimin e saj (në rastin se kostatohet difekt në mjet nga fabrika ose gjatë periudhës së garancisë).

Disponimi i inxhinierit të sipërcituar nga ofertuesit, garanton AK për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e autoveturave objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr.1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike (servis) për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve brenda periudhës së garancisë së dhënë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Servisi/et duhet të jetë i pajisur me licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove te reja ose te perdorura”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) me qëllim ushtrimin e ligjshëm të aktivitetit të tij. Ky kriter garanton AK-në se operatori ekonomik fitues zotëron kualifikimet e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës. (në rastin se kostatohet difekt në mjet nga fabrika ose gjatë periudhës së garancisë).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të veprohet konform parashikimeve të LPP.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Mjet zjarrëfikës pick up 4x4

Viti i Prodhimit	Minimumi 2024;
Gjendja	e Re e paperdorur;
Karburanti	Nafte;
Emetimi i Gazrave	Minimum Euro 6;
Kambio	Manuale ose automatike ;
Cilindrata	Min. 2800 CC - Max. 3000 CC
Fuqia e motorrit	Min. 95 kW -Max.110 kW;
Sistem A/C Ajer i kondicionuar	Po;
Xhamat para	Komandim elektrik;
Timoni	Hidraulik;
Distanca midis akseve	Min. 3400 mm - Max. 3,500 mm;
Numri i akseve	2
Konfigurimi i akseve	4x4;
Pesha totale e mjetit me ngarkes	Min. 3000 kg – Max. 4000 kg;

Gjatesia totale e mjetit	Min. 5,500 mm - Max. 6,000 mm;
Gjeresia totale e mjetit	Min. 1,900 mm - Max. 2,200 mm;
Numri i dyerve të kabinës	4
Numri i pasagjerëve në kabinë	2+3
Ngjyra e mjetit	E kuqe - RAL 3000;

DEPOZITA E UJIT

Kapaciteti i depozites se ujit Minimumi 400 Litra;
 Materiali i depozites duhet te jete prej Celik karboni, trashesia Min. 4 mm;
 Superstruktura te jete e pergatitur me material Anti korrozion;

DEPOZITA E SHKUMËS

Kapaciteti I depozites se shkumes duhet te jete Min. 50 L;
 Materiali i depozites se shkumes duhet te jete prej Celik inox, trashesia Min. 4 mm;
 Superstruktura te jete e pergatitur me material anti korrozion dhe lehtesisht te pastrueshem;
 Njesia e prodhimit te shkumes mesatarisht 3% - 6%

POMPA E ZJARRËFIKSES

Presioni në dalje	Min. 0.65 Mpa;
Vakumi Maks.	Min. 85 kpa;
Koha e primimit	Min. 10 s;

PISTOLETA E SHUARJES SE ZJARRIT

Prurja	Min. 15 L/s;
Distanca e hedhjes se ujit	Min. 30 m;
Kendi i rrotullimit	360 °;

TUBACIONET

Baraban me tub presioni te larte me gjatesi 50m, me mbledhje manuale ose elektrike;	
Tubacioni i thithjes	1 DN50;
Tubacioni ne hyrje	1 DN70 ;

SINJALISTIKA

Sistem sinjalizimi vizual me drita ne pjesen e siperme te kabines dhe ne pjeset anesore te superstruktures.

Sistem sinjalizimi zanor sirene emergjence;

PAJISJET

Pistolet uji/shkume	1 cope;
Tub thithje	1 cope 50;
Celes Hidrant	1 cope;
Lirues tubash	2 cope;
Bombel fikse zjarri	1 cope;
Dare prerese	2 cope;
Sopat zjarri	1 cope;
Batanie zjarri	4 cope;
Kostum zjarrefiksi	4 cope
Shkalle zjarrefiksi	1 cope(6 m)

- Garancia e automjetit zjarrfikës të jetë për një periudhë kohe jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit të tij nga operatori ekonomik fitues; Për me tepër autoriteti kontraktor si formë garancie nuk do të çlirojë sigurimin e plotë të kontratës të paguar nga operatori ekonomik fitues. Në çdo rast, të paktën 25% e vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës, do të mbetet si garanci deri në përfundim të afatit të sigurimit të kontratës në përputhje me parashikimet e nenit 36 pika 2 të VKM-së Nr 285 datë 19.05.2020 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.
- Në çmim përfshihen veprimet që kryhen për sjelljen e automjetit zjarrfikës pranë autoritetit kontraktor, zhdoganimin dhe shpenzime të tjera deri në targimin e automjetit dhe me regjistrimin e tij (leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, targa, siguracion etj).

Në hartimin e specifikimeve teknike njësia e prokurimit i ka qëndruar me rigorozitet kuadrit ligjor në fuqi dhe Rekomandimit të APP, duke caktuar një minimum të mundshëm për specifikimet konkrete të mjetit, si fuqia e motorit, pesha e tij, dimensionet, kapaciteti i rezervuarit, kapaciteti i shkumës etj, duke lënë të hapur garën ndërmjet operatorëve ekonomik.

Plotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatet dhe ofertuesit, dhe nuk shërbejnë si pengesë për konkurimin e hapur për prokurimin publik.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se hartimi i specifikimeve teknike është kryer në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Hartimi i specifikimeve teknike përmbushen nga një shumëllojshmëri markash dhe modelesh, duke rritur njëkohësisht konkurrencën midis operatorëve ekonomik të interesuar.

Mosplotësimi i specifikimeve teknike si më sipër cituar nga ana e operatorëve ekonomik ofertues, do të çoj në skualifikimin e operatorit ekonomik.

Mjeti do të merret në dorëzim nga një komision i posaçëm, vetëm në rastet kur plotësohen specifikimet teknike të hartuar nga autoriteti kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT